

PËRFAQËSIMI DHE NXITJA E POLITIKAVE TË BASHKËPUNIMIT DHE TË NDËRVEPRIMIT ME TË GJITHË SHQIPTARËT,
DUKE NXITUR E FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN NË TË GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARËT JASHTË KUFIJVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHTETET KU ATA BANOJNË

#59

Sfidat e rrugëtimit të parë të Qendrës së Botimeve për Diasporën



Një vit më parë nisi punën e saj Qendra e Botimeve për Diasporën, institucion në shërbim misionit të Ministrit të Shtetit për Diasporën. Misioni i kësaj qendre është mbështetja e mësimit të gjuhës shqipe, njohja dhe përhapja e kulturës kombëtare përmes botimit të teksteve shkollore, librave me përbajtje letrare, historike, sociale etj, si dhe organizimi dhe mbështetja e veprimtarive edukative për shqiptarët në Diasporë. Në një intervistë për "Gazeta Diaspora" drejtoresha e kësaj qendre, znj. Mimoza Hysa, tregon për projektet e realizuara gjatë kësaj kohe, rrugëtimin e bëri deri më tanë dhe të ardhmen e qendrës.


"...l kërkova rrënjet e kësaj nismë në "Shoqerinë e të shtypurit të shkronjavet shqip" të Stambollit, më 1879, e cila mund të themi se është e barasvlerishmeja qndrës sonë, ngritur me mund dhe sakrifica gati një shekull e gjysmë më parë nga patriotët shqiptarë në Diasporë, të cilët sllën abetaret dhe librat e parë të mësimit të gjuhës shqipe në atdhe. Qendra jonë u ngrit për të përmushur një mision dhe detyrim të rëndësishëm që kemi të gjithë në drejtim të ruajtjes dhe përhapjes së gjuhës shqipe, tashmë në kahun e kundërt, nga Atdheu në Diasporë", shprehet ndër të tjera znj. Hysa.

Qendra e Botimeve për Diasporën përvuron sallën "Fan Noli"



Në përvjetorin e parë të funksionimit të saj, Qendra e Botimeve për Diasporën përvuroi sallën "Fan Noli", e cila është e pajisur me mjete profesionale cilësore për procesin e punës së saj, për të siguar përgatitjen e librave në formatin e-book, si dhe gjithçka tjetër të nevojshme për platformën digitale kushtuar mësimdhënieς në Diasporë.

Drejtoresha Ekzekutive e QSPA-së, intervistë për televizionin News 24



Në një intervistë për televizionin News 24, Drejtoresha Ekzekutive e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët, prof. Diana Kastrati, flet për botimet që pritet të dalin për herë të parë nga kjo qendër, aktivitetet, si dhe rolin që ky institucion do të ketë në përnditjen e kontributit të arbëreshëve në lëminë e historisë, gjuhësishë, letërsisë, antropologjës kulturore etj. Ajo thekson se nuk ka ndodhur ndonjëherë në historinë e njerëzimit që një komunitet i ikur pothuajse 6 shekuj më parë, të ketë në fokus të tij, jo vetëm ruajtjen e gjuhës, por gjithçka që përbën konstitucioni shpirtor dhe mendor i kësaj popullate. Gjatë intervistës së saj, studuesja dhe përkthyesja Diana Kastrati, tregon se lidhja e saj me arbëreshët nis qysh në fëmijërinë e hershme pranë të atit, akademikut e studiuesit Jup Kastrati, gjë që e bën detyren e saj jo vetëm më të ndjeshme, por edhe më sfiduese.

Qendra e Botimeve për Diasporën përvuron fjalorët dygjuhësh

Në përvjetorin e parë të funksionimit të saj, Qendra e Botimeve për Diasporën përvuroi botimin e fjalorëve dygjuhësh për fëmijë: shqip-anglisht; shqip-italisht; shqip-greqisht dhe shqip-ukrainisht. Fjalorët do të ofrohen falas për fëmijët në Diasporë me qëllim mbështetjen e mësimit të gjuhës shqipe jashtë vendit.



KKD/ Gazmend Kapllani pjesë e takimit të parë kulturor online



Anëtar i Këshillit Koordinues të Diasporës si drejtues i Katedrës Albanologjike në DePaul Gazmend Kapllani pjesë e takimit të parë kulturor online të shtunën më 9 maj me Aleancën Kulturore Amerikano-Shqiptare në Universitetin DePaul në Çikago të SHBA-së. Nëpërmjet një publikimi në rrjetet sociale bëhet e ditur se gjatë këtij takimi dyorësh u shfaq filmi "Anija/La Nave" (2012) e Roland Sejkos që rrëfen historinë e eksosit masiv të shqiptarëve në vitet '90.

KKD / Adriana Fishta-Bejko analizë për mësimdhëni pas pandemisë




Anëtarja e Këshillit Koordinues të Diasporës dhe Drejtoresha e Shkollës Shqipe "Foleja e Shqiponjave" në Calgary të Kanadasë, Dr. Adriana Fishta-Bejko bën një analizë të situatës së mësimdhënieve nën ndikimin e pandemisë dhe masave kufizuese të marra për shkak të saj. Ajo flet për problematikën e mësimdhënieve online, si ndikojnë ndryshimet në mësimdhënieve për prindërit në vendin ku jeton dhe cilat janë vështirësitë që hasin prindërit emigrantë lidhur me edukimin e fëmijëve e si mund të kapërcehen ato.

Për më shumë informacione nga Diaspora viziton:

www.diasporashqiptare.al

Aplikacioni informues "Diaspora Shqiptare"



App store [këtu](#) Play store [këtu](#)


Aplikacioni gazeta "Diaspora Shqiptare"

SHKARKO
APLIKACIONIN FALAS



App store [këtu](#) Play store [këtu](#)

"Raporto" problemin në çdo kohë në Ambasadalme



App store [këtu](#) Play store [këtu](#)

KKD / Adriana Fishta-Bejko analizë për mësimdhëni pas pandemisë



Anëtarja e Këshillit Koordinues të Diasporës dhe Drejtoresha e Shkollës Shqipe "Foleja e Shqiponjave" në Calgary të Kanadasë, Dr. Adriana Fishta-Bejko bën një analizë të situatës së mësimdhënieve nën ndikimin e pandemisë dhe masave kufizuese të marra për shkak të saj. Ajo flet për problematikën e mësimdhënieve online, si ndikojnë ndryshimet në mësimdhënieve për prindërit në vendin ku jeton dhe cilat janë vështirësitë që hasin prindërit emigrantë lidhur me edukimin e fëmijëve e si mund të kapërcehen ato.